

VENDIM
Nr. 117, datë 24.4.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 20, 37, pika 2, germa “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 17, pikat 2, 3 dhe 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016; neneve 4, germa “b”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/2 prot., datë 23.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria ‘HEC Polemi’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tri degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005 prot., datë 30.3.2026, shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën për transferimin e plotë të licencës së sipërcituar, te shoqëria e krijuar “HEC Polemi” sh.p.k., me ortak të vetëm shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe do të operojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për transferim, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 17, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin/informacionin e kërkuar për transferimin e licencës sipas germave (“b” dhe “c”).

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 17 “Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës”:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë të dhënat e kërkuara në zbatim të germave “b” dhe “c” të shtojcës 1 të Rregullores.

- Germa “d”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës për vlefshmërinë e marrëveshjes së transferimit, të përcaktuar në këtë marrëveshje.

- Germa “f”: Shoqëria duhet të depozitojë miratimin apo qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me këtë transferim.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 17, pika 1 dhe 5 të Rregullores së licencimit, ku përcaktohet, se: aplikimi për transferimin e aseteve fikse duhet të bëhet paralelisht me aplikimin për transferimin e licencës, sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, dhe duke qenë se, sa informuar nga shoqëria, transferimi i licencës do të shoqërohet dhe me transferimin e plotë të aseteve të hidrocentralit, vlerësohet fillimi i procedurës dhe për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës në zbatim të Rregullores së transferimit të aseteve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 577, seria P24, dhënë shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

2. Të fillojë procedurën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti